

**C.nr.740/2016**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil** me gjyqtaren Mirvete Alidema, në çështjen juridike të paditëses K. E e K, Sh.A, Distrikti në Gj ndaj të paditurit: Sh.Sh. A. nga fshati V, K.e Gj, me bazë juridike: kompenzimin e dëmit material, jashtë seancës më dt. 30 Mars 2018 mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **Për shkak të padëgjueshmërisë (Mosbindjes)**

**I. Aprovohet** kërkesëpadija e paditëses K. E. K, Sh.A, D. në Gj si e bazuar dhe **Obligohet** i padituri Sh. Sh. A. nga fshati V, K e Gj, që paditëses t'ia kompenzoj dëmin material në shumë prej **456.44 €** (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e katërdhjetë e katër cent), me kamatë ligjore prej ditës së paraqitjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

**II. Obligohet** i paditurit që paditëses t'ia paguajnë shpenzimet procedurale në shumë prej **20 €**.

### **A r s y e t i m**

Paditësja, ka paraqitur padi në këtë gjykatë më datën 07.09.2016, ndaj të paditurit Sh Sh nga fshati V, Ke Gj, për kompenzimin e dëmit material në shumë prej **456.44 €** (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e katërdhjetë e katër cent), me kamatën ligjore prej datës së paraqitjes së padisë e deri në datën e pagesës përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Pas pranimit të padisë kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dh 395 të LPK-ës, palëve të paditura i ka dërguar padinë së bashku me shkresat e lëndës në mënyrë që të njëjtit të përgjigjen lidhur me pretendimet e tyre, njëkohësisht duke i paralajmëruar të paditurit që nëse brenda afatit të paraparë ligjor nuk përgjigjen, gjykata do të merr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë-mosbindjes.

Meqë i padituri edhe pse e ka pranuar Aktvendimin për përgjigje në padi, me datën 06.07.2017, të njëjtës nuk i është përgjigjur fare.

Ndërkaq në padi përfaqësuesi i paditëses ka deklaruar se i padituri prej datës së parë të vërtetuar e deri më datën 11.02.2010, në shtëpinë e tij me qëllim t'i sjellë vetit pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, duke keqpërdorur njehsorin elektrik ashtu që nga rrjeti i të demtuarës ...është konstatuar se konsumatori ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar jashtë njehsorit elektrik, ku nga konzolla e objektit të vjetër ka furnizuar drejtëpërdrejt objektin e ri, ku me këtë veprim ka pamundësuar regjistrimin e energjisë elektrike të shpenzuar, dhe kështu i ka shkaktuar paditëses dëmit material në vlerë prej 456.44 €.

Paditësja së bashku me padi, gjykatës ia ka prezentuar provat materiale siç janë: Aktgjykimin penal të formës së prerë të datës datës ...të Gjykatës Komunale në Gj, i cili ka marr formën e prerë më dt..., Transakcionet e konsumatorit nga data 01.01.2016-...urdhërpagesën e dates....

Me që i padituri, në afatin e paraparë ligjor nuk ka paraqitur përgjigje në padi, gjykata duke u mbështetur në nenin 150.1 nën (a) dhe (b) lidhur me nenin 388 të LPK-ës, mori aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë dhe vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, meqë themelësia e kërkesë padisë bazohet në faktet e treguara në padi si dhe që faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuara vet paditësi.

Gjykata vendosi që shpenzimet e procedurës gjyqësore në mbështetje të nenit 452 par.1 të LPK-ës të bien në barrë të të paditurit.

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

Më 30.03.2018

### **Gjyqtarja**

Mirvete Alidema

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëpërmes të kësaj gjykate.